



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-027
Prishtinë, më 7 korrik 2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 7 KORRIK 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti Slobodan Petroviq dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, Donika Kada-Bujupi, Sasha Milosavljeviq, Enver Hoti dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi dhe Avni Bytyçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe disa përfaqësues të organizatave dhe të Shoqërisë Civile dhe të tjerë, që i përcjellin punimet e Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe nëntë (9) pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 23 qershor 2015,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave dhe
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 23 qershor 2015

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 23 qershor 2015.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari fillimisht i njoftoi anëtarët e Kryesisë se kanë mbetur edhe katër (4) pika të papërfunduara nga seancat plenare, të mbajtura më 6, 7, 8, 14 maj, si dhe më 25 qershor e 2 korrik 2015, si në vijim.

1. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me petitionin e qytetarëve të Rahovecit për ndriçimin e fatit të Ukshin Hotit,

2. Rekomandimet e Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me petitionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike.

3. Emërimi i anëtarit në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,

4. Shqyrtimi i raportit vjetor për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikat e lartshënuara, të njëjtat i radhiti në rend të ditës për seancën plenare, që do të mbahet më 9 korrik 2015.

Më pas, Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet të enjten, më 9 korrik 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,*
- 4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015,*
- 5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për faljen e borxheve publike,*
- 6. Shqyrtimi i raportit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2014,*
- 7. Shqyrtimi i raportit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2014,*
- 8. Zgjedhja e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës,*
- 9. Votimi i rekomandimit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin e qytetarëve të Rahovecit për ndriçimin e fatit të Ukshin Hotit,*
- 10. Votimi i rekomandimeve të Komisionit për të Drejta e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike,*
- 11. Votimi për emërimin e anëtarit në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,*
- 12. Votimi i raportit vjetor për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2014.*

3. Shqyrtimi i propozimeve, kërkesave dhe njoftimeve

- 1. Kërkesa e ish-kryetarit të Kuvendit, z. Jakup Krasniqi, lidhur me vendimin e Kryesisë së Kuvendit, nr.05-V-06*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e ish-kryetarit të Kuvendit gjatë legjislativave III dhe IV, z. Jakup Krasniqi, kërkoi nga Administrata e Kuvendit që ta zbatojë vendimin e Kryesisë së Kuvendit, nr.05-V-06, datë 21 janar 2015 lidhur me realizimin e të drejtave për ish-kryetarin e Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

- 2. Njoftimi i Grupit Parlamentar të Listës serbe për zëvendësimin e kryetarit dhe zëvendësit të këtij grupi parlamentar*

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se Grupi Parlamentar i Listës serbe për kryetar të këtij e ka caktuar deputetin Slavko Simiq, në vend të deputetit Sasha Milosavljeviq, ndërsa zëvendëskryetare e këtij grupi është caktuar deputetja Jelena Bontiq.

Kryetari e falënderoi kryetarin e deritanishëm të GP të Listës serbe, z. Sasha Milosavljeviq, për bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë.

4. Pikat shitesë:

1. Procedimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Projektligjin për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të hartuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në afatin sa më të shpejtë të mundshëm.

2. Zgjedhja e Auditorit të Përgjithshëm

Kryesia e radhiti pikën e lartshënuar në rend të ditës për seancën plenare, që do të mbahet më 9 korrik 2015.

3. Kërkesa e deputetes Albulena Haxhiu, e mbështetur nga 5 deputetë nënshkrues, për debat parlamentar lidhur me veprimtarinë e misionit të BE-së në Republikën e Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, vendosi që kjo kërkesë, bazuar në Rregulloren e Kuvendit, brenda tri javë pune të radhitet në rend të ditës në njërën nga seancat plenare të radhës.

4. Ratifikimi i vendimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës për themelimin e “Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj”, si institucion publik i arsimit të lartë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, si Komision Funkcional që ta shqyrtojë vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës për themelimin e “Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj”, si institucion publik i arsimit të lartë dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

5. Kërkesa për ndihmë financiare për realizimin e himnit për nder të nobelistes dhe figurës kombëtare Gonxhe Bojaxhiu (Nëna Terezë)

Kryesia diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, por vendimarrjen e shtyu për mbledhjen tjetër.

5. Të ndryshme:

Nënkryetarja e Kuvendit znj. Duda Balje, në emër të GP “6+”, i propozoi Kuvendit të Kosovës me rastin e 20-vjetorit të Masakrës së Serbenicës ta nxjerrë një rezolutë për këtë çështje.

Lidhur me propozimin e nënkryetares së Kuvendit diskutuan: Donika Kadaj-Bujupi, Adem Grabovci dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari tha se lidhur me çështjen e shtruar nga nënkryetarja e Kuvendit, znj. Duda Balje, në fillim të seancës më 9 korrik 2015 Kuvendi do ta mbajë një minutë heshtje në shenjë përkujtimi dhe respekti për viktimat e Masakrës së Serbenicës të vitit 1995.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 12:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale